



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE

Nr.10/26 Prot.

Tiranë më, 26/01/2023

V E N D I M

Nr. 07 datë 26.01.2024

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

Denisa Sina	Kryesues
Suela Bulku	Relator
Arben Sefaj	Anëtar

në datën 25.01.2024, në orën 09:30, në ambientet e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket:

SUBJEKTI I VLERËSIMIT: **Z. Vasil Petro Dode**, me funksion ish - Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit, në Gardën e Republikës

OBJEKTI: **Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Ligji nr. 12/2018**, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

TRUPA E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE,

pasi dëgjoji dhe vlerësoi shpjegimet dhe argumentimin ligjor të Relatorit të çështjes, Znj. Suela Bulku; pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është institucioni përgjegjës për kryerjen e procesit të vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, bazuar në Ligjin nr.12/2018, “*Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme*”, i ndryshuar.
2. Subjekti i vlerësimit kalimtar, Vasil Petro Dode, ka dorëzuar *deklaratën e pasurisë, deklaratën e kontrollit të figurës dhe formularin e vlerësimit të aftësive profesionale*, për funksionin Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit, në Gardën e Republikës, sipas përcaktimeve të neneve 32, pika 2, 36 pika 1, dhe 44 pika 1, të Ligjit nr.12/2018, “*Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme*”, i ndryshuar.
3. Bazuar në nenin 6 të Ligjit nr.12/2018 “*Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme*”, i ndryshuar, Vasil Dode ka qenë subjekt i vlerësimit kalimtar nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit që mbante në datën e hedhjes së shortit, si Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit, në Gardën e Republikës.
4. Subjekti i vlerësimit, Vasil Dode, iu nënshtrua procedurës së shortimit, në shortin e zhvilluar në datën 05.04.2023, nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr.07, datë 17.01.2023 “*Për Procedurat e Hedhjes së Shortit*”. Sipas shortit të zhvilluar, Trupa e Vlerësimit përbëhet nga Znj. Denisa Sina (Kryesues), Znj. Suela Bulku (Relatore) dhe Z. Arben Sefaj (Anëtar).
5. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e Trupës së Vlerësimit, sipas nenit 27, pika 1 të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar dhe neneve 30 dhe 31, të Kodit të Procedurave Administrative.
6. Trupa e Vlerësimit në përputhje me Ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar si edhe në bazë të Rregullores nr. 197, datë. 28. 02. 2023, “*Për hapat proceduralë të unifikuar*”, vendosi me Vendimin nr.1, datë 18.04.2023, fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Vasil Dode si dhe të caktojë Kryesues të Trupës Vlerësuese Znj. Denisa Sina.

7. Relatori i çështjes, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar të datës 18.04.2023, njoftoi subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar duke i bërë të njohur përbërjen e Trupës së Vlerësimit dhe duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupës së vlerësimit.
8. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, “Deklaratën për Konfliktin e Interesit” me nr. *** prot. datë 20.04.2023, duke shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit.
9. Relatori i çështjes, në përmbushje të detyrave ligjore të përcaktuara në pikën 3, të nenit 25, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, dhe sipas:
 - nenit 7, pika 1, të Rregullores nr. 197, datë 23.02.2023, “Për hapat proceduralë të unifikuar”, nenit 4, të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore dhe Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit, ka dërguar me shkresën nr.*** prot., datë 19.04.2023 , pranë ILDKPKI-së, formularin e deklarimit të pasurisë për vlerësimin kalimtar të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit .
 - nenit 7, pika 7, të Rregullores nr. 197, datë 23.02.2023, “Për hapat proceduralë të unifikuar”, ka dërguar me shkresën nr.*** prot., datë 19.04.2023, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, formularin e aftësive profesionale për vlerësimin kalimtar të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit.
 - nenit 7, pika 4, të Rregullores nr. 197, datë 23.02.2023, “Për hapat proceduralë të unifikuar”, ka dërguar me shkresën nr.*** prot., datë 19.04.2023, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, deklaratën e kontrollit të figurës për vlerësimin kalimtar të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit.
10. Garda e Republikës, me shkresën nr *** prot., datë 12.12.2023, ka informuar Trupën e Vlerësimit në lidhje me Urdhërin nr ***, datë 11.12.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm të Gardës së Republikës “Për lirimin nga detyra” të Z. Vasil Dode, me kërkesën e tij.
11. Në vijim, Relatori i çështjes, njoftoi për ndërprerje të procesit të hetimit administrativ për subjektin e vlerësimit, Z. Vasil Petro Dode.

II. ARSYETIMI LIGJOR I TRUPËS SË VLERËSIMIT

12. Në zbatim të Ligjit nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, sipas nenit 3, pika 18 e tij, “subjekt vlerësimi” janë punonjësit sipas përcaktimeve të bëra në pikat 15,16 dhe 17, të këtij neni.
13. Subjekti i vlerësimit, Z. Vasil Dode, është liruar nga detyra me kërkesë të tij dhe ky vendim është formalizuar gjatë fazës së hetimit administrativ. Në këto kushte, gjendemi në kriteret e përcaktuara në nenin 57, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
14. Sa më sipër, Trupa e Vlerësimit deklaroi të përfunduar çështjen e hetimit administrativ të nisur ndaj subjektit të vlerësimit, pa një vendim përfundimtar për shkak se interesi, qëllimi

dhe objekti për të cilin ka nisur procedura janë bërë ligjërisht të pamundur, duke konstatuar se ndodhet në kushtet e zbatimit të nenit 95, të Kodit të Procedurës Administrative.

PËR KËTO ARSYE

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, mbështetur në Ligjin nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, si dhe në nenin 95, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë;

V E N D O S I:

1. Ndërprerjen e procesit të vlerësimit kalimtar të subjektit të vlerësimit **Vasil Petro Dode**, me funksion ish-Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit, në Gardën e Republikës, pa një vendim përfundimtar.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim, u njoftohet Subjektit të Vlerësimit si edhe Gardës së Republikës, brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së Vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim u shpall sot datë 26.01.2024, në Tiranë.

TRUPA E VLERËSIMIT

Denisa SINA

Kryesues

Suela BULKU

Relator

Arben SEFAJ

Anëtar